



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1362 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 214, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit Hidroenergjitik të Devollit-"*HEC Moglicë, Siti Nr. 9 (Mbetje e këmbës së një ure mesjetare në fshatiin Nikollarë, që ndodhet në traktin Nr. G-51)*" -subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit Hidroenergjitik të Devollit-"*HEC Moglicë, Siti Nr. 9 (Mbetje e këmbës së një ure mesjetare në fshatiin Nikollarë, që ndodhet në traktin Nr. G-51)*" -subjekti "Devoll Hydropower" sh.a, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit në kuadër të projektit Hidroenergjitik të Devollit sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur më parë për këtë zonë, ndërmjet subjektit "Devoll Hydropowr" sh. a., Subjektit të licencuar në arkeologji dhe ASHA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARILKKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al